



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 15.10.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 11.10.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "BESA SECURITY" për aktivitetin: "Sigurimi i objekteve të Komunes së Prishtinës" dhe me numër të prokurimit: **616-19-3238-211** nxjerr:

VENDIM

1. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomike "Besa Security" e datës 11.10.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Sigurimi i objekteve të Komunes së Prishtinës" dhe me numër të prokurimit: **616-19-3238-211** kundër *Njoftimit për Vendimin e Autoritetit Kontraktues* të datës 10.10.2019, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.
2. **Vërtetohet Njoftimi i Autoritetit Kontraktues** i publikuar me datë: 10.10.2019;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë respektimin e Vendimit të datës 10.10.2019
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori Ekonomik "" me datë 11.10.2019 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Sigurimi i objekteve të Komunes së Prishtinës" dhe me numër të prokurimit: **616-19-3238-211**.

Autoriteti Kontraktues, me datë 15.10.2019, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës janë plotësisht të pa bazuara për arsyet në vijim:

-Pretendimi se paga mujore duhet të jete 250.00 euro dhe nenkupton edhe të gjitha obligimet tjera është i pa bazuar pasi që sipas Ligjit të punës duhet kalkuluar edhe detyrimet tjera sipas 56,qe nenkupton se duhet kalkuluar puna e nates,ditet e festave dhe puna jashte orarit;

-Arsyetimi se ju e beni zevendseimin me punetor tjer poashtu nuk eshte i qendrueshem sepse edhe gjate periudhes qe e paguani te njejtin 130.00 euro ne muaj njekohesisht jeni te detyruar qe te paguani edhe pagen e punetorit per pushim vjetor.Poashtu nuk qendron fakti se ju keni kalkuluar çmimin tuaj si duhet pasi qe nuk keni kalkuluar ne asnje rast pagesat shtese per oret e nates dhe te festave;

-Poashtu arsyetimi se punetoret per ditet e festave marrin pushim ditor,poashtu nuk eshte i bazuar pasi qe ditet e pushimit duhet ta zevendesoje punetori qe poashtu duhet te paguhet per ate dite;

-Pretendimet tuaja per shkelje te nenit 7,59 dhe 60 jane plotesisht te pa qendrueshme,pasi qe nga Vendimi per rekomandim te tenderuesit fitues mund te shihni qarte se jane analizuar te gjitha deshmitet sipas kerkesave ne FDT dhe nuk ka demtim te buxhetit,por respektim te kerkesave te AK-se dhe rekomandim ne harmoni me te njejtat.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne sqarimet e paraqitura më lartë dhe në sqarimet detale nga Vendimi për refuzim te rekomandimit per kontrate ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimet te ketij vendimi.


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit